

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Juridik</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>E drejta ndërkombëtare private konvencionale</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>IV</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2L+2U</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6 ECTS</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Fakulteti Juridik</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Dr. Asllan Bilalli dhe Prof. Dr. Hajredin Kuçi</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b><a href="mailto:Asllan.bilalli@uni-pri.edu">Asllan.bilalli@uni-pri.edu</a>; <a href="mailto:hajredin.kuci@uni-pr.edu">hajredin.kuci@uni-pr.edu</a></b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Si rezultat i globalizimit dhe lëvizjes së vazhdueshme të njerëzve, mallërave e shërbimeve, e Drejta Ndërkombëtare po pëson ndryshimeve të vazhdueshme dhe po bëhet cdo ditë e më tepër fushë me rëndësi dhe kompleksitet të shtuar. Kjo lëndë është disejnuar në atë mënyrë që t'ju mundësojë studentëve që të fitojnë njohuri të thella mbi konceptet e të Drejtës Ndërkombëtare Private, përfshirë këtu cilësimin, ridërgimin, çështjen paraprake, rendin publik dhe rregullat e detyrueshme.</p> <p>Në këtë lëndë, studentët rivizitojnë rolin qenësor të institucioneve të ndryshme të cilat ndikojnë në zhvillimin e këtyre instituteve të kësaj lëmie, të cilat ndërtojnë dhe harmonizojnë rregullat bashkëkohore për kompetencë, zgjedhjen e të drejtës kompetente dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja.</p> <p>Duke qenë mundësia e dytë e studentëve për të studjuar lëndën e Drejta Ndërkombëtare Private, kjo pjesë e lëndës është ndërtuar në atë mënyrë që t'u oftojë studentëve njohuri më të avancuara të kësaj fushe me qasje <i>praktike</i> më tepër sesa atë teorike.</p> <p>Lënda është zbrëthyer në gjashtë blloqe kryesore, në kuadër të së cilës studentët do të zbrëthojnë temat e detajuara të atij blloku, <i>duke iu përgjigjur në fund detyrave me skenare hipotetike të përpiluara me problematika nga tema e atij blloku.</i></p> <p>Blloku i parë fillon më një përsëritje dhe ri-njoftim të studentëve mbi përmbajtjen e përgjithshme të lëndës, parimet dhe institutet kryesore të saj. Në shtjellimin e këtij blloku fillestar, mësimdhënësi do të këtë mundësinë që të</p>

	<p>vlerësojë aty-për-aty edhe gatishmërinë dhe nivelin e njohurisë së studentëve mbi këtë lëndë, të fituar në nivelet më të ulëta të studimit. Pas përfundimit të këtij blloku dhe shtjellimit të temave kryesore të lëndës, do të vazhdohet me blloqet tjera, të fokusuara në marrëdhënie dhe problematika specifike.</p>
<p><b>Qëllimet e lëndës:</b></p>	<p>Qëllimi i lëndës është që të studjohet në thellësi dhe me qasje më praktike mënyra e rregullimit të marrëdhënieve juridike-private me element të huaj, e cila bëhet përmes njoftimit me këta tre indikatorë: E para, duhet të njihen normat materiale (substanciale) dhe ata kolizive me anën e të cilave rregullohen marrëdhëniet juridike-private me element të huaj. Më pastaj duhet të merren parasysh normat juridike-pozitive të karakterit nacional dhe ndërkombëtar.</p> <p>Pastaj, duhet të njihet praktika gjyqësore dhe ajo e arbitrazhit, e gjykatave dhe arbitrazhave nacionale dhe ndërkombëtare, ngase nëpërmes vendimeve të tyre konkretizohen rregullat juridike që aplikohen për rregullimin e marrëdhënieve juridike-private me element të huaj.</p>
<p><b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b></p>	<p>Në përfundim të kësaj lënde, studentët priten të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tregojnë njohuri më të thelluara për parimet e së Drejtës Ndërkombëtare Private në përgjithësi;</li> <li>- Të tregojnë aftësi të larta analitike në zbatimin e këtyre parimeve dhe instituteve kryesore në praktikë përmes zgjidhjes së skenareve hipotetike;</li> <li>- Të njohin thellësisht institutet kryesore të kësaj fushe dhe të mësojnë zbatimin e tyre në raste konkrete;</li> <li>- Dallojnë normat substanciale nga ato procedurale në të Drejtën Ndërkombëtare Private si dhe efektet e zgjedhjes dhe përcaktimit të ndonjërit nga ato;</li> <li>- Tregojnë aftësi analitike në gjetjen e të drejtës kompetente dhe organeve kompetente në raste studimi;</li> <li>- Njohin dhe të bëjnë dallimin midis fakteve të identifikimit dhe fakteve vendimtare (pikave të lidhjes) në kontekst të përgjithshëm dhe vecanërisht në të drejtën vendore;</li> <li>- Analizojnë në mënyrë kritike të drejtën dhe kompetencën më të përshtatshme për lëmi të ndryshme brenda së Drejtës Ndërkombëtare Private;</li> <li>- Mësojnë dhe aplikojnë parimet dhe institutet e së Drejtës Ndërkombëtare Private në çështjet statusore si dhe në marrëdhëniet detyrimore dhe jo-detyrimore.</li> </ul>

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15 jave	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15 jave	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	1 here ne jave x15 Jave	30
Ushtrime në teren			
Kollokfiume ,seminare	4	4	16
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste ,kuiz ,provim final)	2	2	4
Projektet ,prezentimet ,etj	2	2	4
<b>Totali</b>	<b>22</b>	<b>30</b>	<b>169</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Gjatë semestrit për çdo javë studentët paraprakisht do të njoftohen me materien që do te ligjerohet sipas syllabusit. Gjate ligjërimit në mënyrë inter aktive do të marrin pjese edhe studentët.</p> <p>Për shtjellimin e temave, mësimdhënësi do të përgjedhë doktrinën dhe rastet gjyqësore të gjykatave relevante, kryesisht të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë të cilat do të përdoren për të ndihmuar spjegimin e përmbajtjes por edhe për të nxitur mendimin kritik të studentëve.</p> <p>Gjatë ushtrimeve, studentët do të shtjellojnë raste studimi dhe skenare hipotetike për t'ju ndihmuar atyre zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve praktike.</p>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive në ligjërata dhe ushtrime; shtjellimin e skenarëve në ushtrime dhe ligjerata (10%=10 pikë);</li> <li>• Punimi i vazhdueshëm i detyrave me skenarë hipotetikë punuar për t'u zgjidhur individualisht nga studentët pas cdo blloku (40%=40 pikë);</li> </ul>		

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Provimi Përfundimtar (50%=50 pikë).</li> </ul>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	ASLLAN BILALLI, HAJREDIN KUÇI, E Drejta ndërkombëtare private, Prishtinë, 2013
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>HAIREDIN KUÇI, ASLLAN BILALLI, Zanafilla, zhvillimi historik dhe burimet e të Drejtës Ndërkombëtare Private, Prishtinë, 2006;</p> <p>HAIREDIN KUÇI, ASLLAN BILALLI, Kolizioni i ligjeve, Prishtinë, 2006;</p> <p>ASLLAN BILALLI, Arsyet per aplikimin e normës së kolizionit gjatë rregullimit të marrëdhënieve juridiko civile me element ndërkombëtar dhe element të mbrendshëm (interlokal), E Drejta- Laë, Nr. 1, 2004, Prishtine;</p> <p>ASLLAN BILALLI, Marrëdhëniet juridiko-private me element të huaj dhe mënyrat e rregullimit të tyre, E Drejta-Laë, Nr.1, 2005;</p> <p>ASLLAN BILALLI, Njohja, të provuarit dhe aplikimi i të drejtës së huaj, E Drejta-Laë. Nr.2-4, 2005;</p> <p>ASLLAN BILALLI, Elementet e përgjithshme dhe të përbashkëta të formësimit të normës në të drejtën ndërkombëtare private për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile me element të huaj; E Drejta-Laë, Nr. 2, 2004;</p> <p>ASLLAN BILALLI, Kolizioni i ligjeve te deliktet ne komunikacionin rrugore, E Drejta-Laë, Nr. 1, 1998;</p> <p>ASLLAN BILALLI, Zgjidhja e kontesteve afariste me arbitrazh tregtar nderkombetar, E drejta-Laë, Nr, 1, 2013;</p> <p>ASLLAN BILALLI, Arsyet per ndarjen e pjeses se posacme nga pjesa e pergjithme e te Drejtes nderkombetare private, E Drejta_laë, Nr. 2, 2013.</p> <p>Në gjuhën angleze</p> <p>PIPPA ROGERSON, Collier's Conflict of Laës, 14th Edition, 2013</p> <p>TREVOR C. HARTLEY, International Commercial Litigation, 2009</p> <p>DICEY, MORRIS and COLLINS on The Conflict Of Laës, London: Sëet &amp; Maxëell, 14th Revised Edition, 2008</p> <p>G. C. CHESHIRE, P. M. NORTH AND J.J. FAËCETT, Private International Laë, Oxford: Oxford University Press, 14th Edition, 2008</p> <p>PETER STONE, EU Private International Laë Harmonisation of Laës, Cheltenham: Edëard Elgar Publishing Limited, 2006</p>

	<p>A. BRIGGS &amp; P. REES, Civil Jurisdiction and Judgments, 5th Edition, 2009  A. BRIGGS, THE CONFLICT OF LAËS, Oxford University Press, 2nd Edition, 2008</p> <p>ANTON BEAUMONT, Private International Laë, 1990.  BINCHY, Irish Conflict of Laës 1988.  CHESHIRE, Private International Laë, 1979.  CHESHIRE, NORTH and FAËCETT, Private International Laë, 1999.  COLLIER, Conflict of Laës, 1987.  DICEY and MORRIS on the Conflict of Laës, f.I-II 2000.  GRAVESON, Private International Laë, 1974.  JAFNEY, Introduction to the Conflict of Laës, 1988.  MORRIS, The Conflict of Laës, London 1980.  SCHMITTHOFF, The English Conflict of Laës, London 1954.  ËOLFF, Private International Laë, 1950.  CASTEL, Canadian Conflict of Laës, 1994.  McLEOD, The Conflict of Laës, 1983.  BEALE, A Treatise on the Conflict of Laës, t.I-III, Neë York 1935.  BRILMAYER, Conflict of Laës: Foundations and Future Directions, 1991.  BRILMAYER, Conflict of Laës, Boston 1995.  HAY, Conflict of Laës, 1994.  HAY, ËEINTRAUB, BORCHERS, Conflict of Laës, Cases and Materials, Neë York 2000.  SCOLES, HAY, BORCHERS, SYMEONIDIS, Conflict of Laës, 2000.  NYGH, Conflict of Laës in Australia, Salem 1991.  SYKES, PRYLES, Australian Private International Laë, Sydney 1991.  POSCH, European Private International Laë, 1998.  HARRIS, Cases and materials on International Laë, 1998.</p>
<b>Plani i dizejnuar i mësimi:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	<p><b>BLLOKU I:</b></p> <p><b>Hyrje në të Drejtën Ndërkombëtare Private</b></p> <p>Kuptimi dhe emërimi i së DNP, zhvillimi historik i saj, objekti dhe vendi i së DNP ne sistemin juridik dhe veçoritë karakteristike; Burimet e së DNP;</p>

	Dallimi midis së drejtës kompetente dhe kompetencës së organeve në të DNP.
<i>Java e dytë:</i>	<p><b>BLLOKU I (Vazhdim)</b></p> <p><b>Njoftim me institutet kryesore:</b></p> <p>Elementi i huaj dhe mënyrat e shfaqjes së tij;  Dallimi midis fakteve të identifikimit të elementit të huaj dhe fakteve vendimtare;  Shpjegimi i fakteve vendimtare për marrëdhëniet statusore, marrëdhëniet detyrimore dhe jo-detyrimore.  Cilësimi: rëndësia dhe mënyrat e cilësimit në të DNP.  Çështja paraprake dhe Shmangia nga normat kompetente, llojet e shmangieve dhe mënyra e zbatimit të tyre. Fokus i veçantë në ridërgimin dhe rendin publik.</p>
<i>Java e tretë:</i>	<p><b>BLLOKU II:</b></p> <p><b>Marrëdhëniet statusore me element të huaj</b></p> <p>Faktet vendimtare (pikat e lidhjes) për çështjet statusore;  Trendët bashkëkohore të ndryshimit të pikave të lidhjes nga shtetësia drejt vendqëndrimit.</p> <p>Martesa dhe e drejta e të huajve për t'u martuar dhe krijuar familje në shtetet tjera  Forma dhe kërkesat formale të martesës;  E drejta kompetente për formën e martesës; Zotësia për t'u martuar;  (Mos)Njohja e poligamisë, martesave të gjinisë së njëjtë dhe bashkimeve civile.</p> <p>E drejta kompetente për trashëgiminë, shkurorëzimin, anulimin e martesës, ushqimisë, dhe procedurave të tjera lidhur me këtë.</p> <p>Legjitimimi dhe adoptimi; E drejta kompetente në lidhje me gjininë/originën, kujdestarinë e të miturve dhe problemet lidhur me aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve. Adoptimi dhe njohja ndërkombëtare e adoptimeve.</p>
<i>Java e katërt:</i>	<p><b>BLLOKU II (Vazhdim)</b></p> <p>Njoftimi me Rregulloret përkatëse të BE-së për çështje</p>

	<p>familjare, me fokus të veçantë në Rregulloren Bruksel IIbis. Trendi i njoftimit të autonomisë së palëve në çështjet trashëgimore dhe pronësinë bashkëshortore përmes rregulloreve të BE-së dhe Konventave të Hagës.</p>
<i>Java e pestë:</i>	<p><b>BLLOKU III</b> <b>Marrëdhëniet detyrimore me element të huaj</b></p> <p>Faktet e identifikimit në të drejta dhe detyrime si dhe faktet vendimtare në këto marrëdhënie në të drejtën tonë. E drejta kompetente në marrëdhëniet detyrimore dhe roli i fakteve të ndryshme të identifikimit në këtë analizë. Autonomia e palëve në marrëdhënie detyrimore: caktimi i të drejtës kompetente. Vlefshmëria e marrëveshjeve të këtilla. Njoftim me Rregulloren e BE-së Romë I (për marrëdhënie detyrimore)</p>
<i>Java e gjashtë:</i>	<p><b>BLLOKU III (Vazhdim)</b> <b>Marrëdhëniet jo-detyrimore, deliktet, kuazi-deliktet</b></p> <p>Dallimet konceptuale midis sistemeve në cilësimin e marrëdhënieve të caktuara si detyrimore apo jo-detyrimore. Njoftim me Rregulloren Romë II (për marrëdhënie jo-detyrimore). Deliktet, culpa in contrahendo, dhe përgjegjësia jashtë-kontraktuale për dëmin. E drejta kompetente për rastet e delikteve.</p>
<i>Java e shtatë:</i>	<p><b>BLLOKU IV</b> <b>Kompetenca e gjykatave në rastet me element të huaj dhe procedura para tyre</b></p> <p>Llojet e kompetencës së gjykatave; Kompetenca e përgjithshme, e veçantë (speciale apo specifike) dhe ekskluzive. Kompetenca e gjykatës sipas pëlqimit të palës së paditur. Marrëveshjet e palëve për të zgjedhur gjykatën kompetente; Kërkesat formale, kufizimet dhe vlefshmëria e këtyre marrëveshjeve.</p>

<p><i>Java e tetë:</i></p>	<p><b>BLLOKU IV (Vazhdim)</b></p> <p>Njoftim me Rregulloren e BE-së Bruksel Ibis (për kompetencën dhe njohjen e ekzekutimin e vendimeve në rastet civile dhe komerciale)</p> <p>Lis Pendens (litispendenca) në rastet me element të huaj; Cautio judicatum solvi në këto procedura; Shërbimi ndërkombëtar i dokumenteve.</p>
<p><i>Java e nëntë:</i></p>	<p><b>BLLOKU V</b></p> <p><b>Arbitrazhi ndërkombëtar</b> Arbitrueshmëria (arbitrabiliteti) i çështjeve të ndryshme; Rëndësia e Ligjit për Arbitrazhin; Konventa e New York-ut (1958) për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të Tribunalëve të Arbitrazhit; Ligji model i OKB për Arbitrazhin Ndërkombëtar Komercial; Parimet kryesore në procedurat e Arbitrazhit: Parimi Kompetenz- Kompetenz; Parimi i ndashmërisë së kontratës.</p>
<p><i>Java e dhjetë:</i></p>	<p><b>BLLOKU V (Vazhdim)</b></p> <p>Vlefshmëria e marrëveshjeve të palëve për të Arbitruar Ankimimi ne Gjykatën kompetente për këto procedura; Masat e përkohshme që mund të ndërmerren nga Tribunalet; Mënyrat e marrjes së vendimeve në një procedurë të Arbitrazhit.</p> <p>Analiza e një klauzole model të Arbitrazhit. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja të Arbitrazhit në vendin tonë.</p>
<p><i>Java e njëmbëdhjetë:</i></p>	<p><b>BLLOKU VI</b> <b>Njohja dhe ekzekutimi (përmbarimi) i vendimeve të huaja</b></p> <p>Dallimi midis njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve dhe nevoja e secilit nga këta hapa; Pamundësia për t'i ndryshuar vendimet e huaja: rishikimi dhe rigjykimi i vendimeve të huaja;</p>

	Kushtet për njohje dhe ekzekutim të vendimeve të huaja: plotfuqishmëria, mungesa e kompetencës ekskluzive;
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<b>BLLOKU VI (Vazhdim)</b>  Respektimi i hapave proceduralë; Përputhshmëria me rendin publik të vendit; Përjashtimi i rendit publik si bazë për mos-njohje; Reciprociteti si kusht jo-bashkëkohor si dhe prezumimi i tij në njohje dhe ekzekutim të vendimeve të huaja.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<b>Përmbledhje dhe përgatitje për provimin final.</b>

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<p><i>Studentët duhet të jenë prezent, të paktën 80 përqind të fondit të ligjëratave dhe ushtrimeve.</i></p> <p><i>Studentët kërkohet të jenë pjesëmarrës aktivë në ligjërata, ushtrime dhe seminare/prezantime.</i></p> <p><i>Ligjëratat janë të obligueshme.</i></p> <p><i>Ushtrimet janë të obligueshme.</i></p> <p><i>Pjesëmarrja në kolokvium u mundësohet studentëve që janë të rregullt në ligjërata dhe ushtrime.</i></p>